



02Nr. 581 /2025  
27.01.2025

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197 në nenin 78 paragrafi 2, neni 80 dhe 81, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8, Udhëzimit Administrativ nr.34/2014 Funksionimi i Shërbimit Pedagogjik-Psikologjik në Shkollë Rregullore (QRK) nr.19/24 Për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Komuna Hani i Elezit shpallë:

## KONKURS

**Institucioni:** Komuna Hani i Elezit  
**Drejtoria:** Drejtoria për Arsim

**1. Titulli i vendit të punës:** Psikolog/e  
**njësia/ sektori:** SHFMU “Ilaz Thaçi”  
**Numri i pozitave:** Një (1) pozitë me kohë të pacaktuar  
**Koeficienti/Grada:** E18-5.7  
**Orët e punës:** 20 orë

### Detyrat dhe përgjegjësitë për Psikolog/e :

- Psikologu ka detyrë të kontribuojë në lehtësimin e procesit të të nxënësve dhe promovon zhvillimin kongnitiv, emocional, social dhe personal të nxënësve
- Psikologu ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë
  - Psikologu punon me nxënës për të zhvilluar strategji efektive të të nxënësve, zhvillimit social e personal të nxënësve
  - Psikologu bashkëpunon me mësimdhënësit, prindër dhe komunitetin
  - Psikologu ofron konsultime me mësimdhënës, prindër dhe komunitetin me qëllim të shëndetit sa më të mirë të nxënësve
  - Psikologu bashkëpunon me institucionet profesionale të shkollës, institucione të tjera sociale dhe shëndetsore dhe organizata të tjera me qëllim të përvetësimit të praktikave të mira
  - Kryen edhe punë të tjera që i cakton drejtori/esha e institucionit e që janë në pajtim me ligjet në fuqi.

### Kushtet e përgjithshme në rekrutim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë e/i denuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Të mos ketë fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik

## Kualifikimi për Psikolog/e

Kandidatët e interesuar duhet të kenë përgaditje shkollore të nivelit **Master në degën e Psikologjisë-drejtimi Psikologji shkollore dhe Këshillim, të Fakultetit Filozofik**, sipas UA.34/2014 Funksionimi i Shërbimit Pedagogjik-Psikologjik në Shkolla

### Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

### Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

-Procedura e vlersimit bëhet sipas Rregullorës (QRK)nr.19/2024.

**Vërejtje:** në mungesë të kandidatëve të kualifikuar të specifikuar si më lart, do të vijne kandidatët me kualifikim adekuat me 180 ECTS për një vit shkollor,e në rast të mungesës edhe të kandidatëve me 180 ECTS atëherë në konsideratë do të vijne kandidatët e profileve (drejtimeve) të përafërta të cilët do të pranohen për nje vit shkollor.

### Afati dhe mënyra e aplikimit:

**Pranimi i aplikacioneve bëhet mbrenda ( 30) ditëve nga data 28.01.2025 deri 26.02.2025 nga ora 08:00-16:00**

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>  
Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.  
Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës  
**Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.**

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>,në web faqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezidhe> në tabelën e shpalljes.

Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi

